



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostiguar Prijeno/Prodato Received/Delivered	06.03.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHC	2394/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.734/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.2443/2021 të datës 27.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.734/2021 të datës 12.08.2021 të parashtruar nga ankuesja [] nga Prishtina, kundër heshtjes administrative të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 03.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.734/2021 të datës 12.08.2021, të parashtruar nga ankuesja []

A r s y e t i m

Ankuesja [], e punësuar në Komunën e Prishtinës, më datë 12.08.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4194/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Komunës së Prishtinës lidhur me kërkesën e ankueses të datës 05.07.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.08.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli më datë 24.08.2021 ka pranuar përgjigjeje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli përmes Njoftimit me numër protokollit 479/2021 të datës 28.09.2021, ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës numër A.nr.734/2021 të datës 12.08.2021 duke udhëzuar të njëjtën mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.2443/2021 të datës 27.01.2023, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në këtë rast ankueses si dhe ka anuluar njoftimin e datës 05.11.2019 të Këshillit, duke e obliguar tw



njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.734/2021 të datës 12.08.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4194/2021 të datës 12.08.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 08.11.2012 të ankueses; Kërkesën e datës 05.07.2021 e parashtruar nga ankuesja për kthim në vendin e punës; Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special; Aktgjykimin PKR.nr.358/18 i datës 10.11.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Vendimin me numër 01.nr.118-87652 të datës 11.04.2014 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për pezullim parandalues të ankueses; Përgjigjen në ankesë e datës 24.08.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.08.2021; Njoftimin e datës 28.09.2021; Aktgjykimin A.nr.2443/2021 të datës 27.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar Aktgjykimin A.nr.2443/2021 të datës 27.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, konstaton që objekti i ankesës së ankueses Drita Rukiqi është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Komunën e Prishtinës, përkatësisht e njëjta sipas Akt Emërimit të datës 08.11.2012, ka qenë e emëruar në pozitën *Inspektore e Ndërtimit*, në Sektorin e Ndërtimit. Me Vendimin me numër 01.nr.118-87652 e të datës 11.04.2014 të Kryetarit të Komunës, ankuesja ishte pezulluar me 50% të pagës deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, për shkak së ndaj ankueses ishte iniciuar procedurë penale për shkak të dyshimit për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj.

Me tej nga provat e lëndës rezulton së Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin PKR.nr.359/18 të datës 10.11.2020 ka shpallur fajtor ankuesen për penale sipas nenit 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës, duke i shqiptuar dënim me burim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e saj është shndërruar në dënim me gjobë në shumë prej 10.000 Euro. Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti Special, në procedurë të mjeteve juridike me Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021, ka bërë ndryshimin e Aktgjykimit PKR.nr.359/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, duke e liruar nga akuza ankuesen për shkak së nuk është provuar që e njëjta ka kryer vepër penale "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" sipas nenit 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës.

Pas Aktgjykimit APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021, ankuesja më datë 05.07.2021 ka parashtruar kërkesë të Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Drejtoria e Inspektionit, Administratës dhe Financave, për kthim në vendin e punës, shfuqizimin e Vendimit për pezullim parandalues të datës 11.04.2014, si dhe kompensimin e të gjitha ndalesave të bëra deri në kthimin e ankueses.

Pas heshtjes administrative të organit të punësimit, ankuesja me datë 12.08.2021 ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore që Kryetari i Komunës ta kthejë ankuesen në vendin e saj të punës, të shfuqizojë Vendimin për pezullim parandalues të datës 11.04.2014, si dhe të kompensojë të gjitha ndalesat e bëra deri në kthimin e ankueses përfshirë edhe kamatën ligjore prej 8%.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji nga analizimi i poroave të lëndës ka konstatuar se pas parashtrimit të ankesës në Këshill, Kryetari i Komunës së Prishtinës më datë 27.10.2021 kishte nxjerrë Vendimin Nr.14-112/03-229797/21 të datës 27.10.2021, ku në pikën I të dispozitivit ka vendosur që ankuesja të kthehet në vendin e punës Inspektore e Ndërtimit nga data 01.11.2021, në pikën II të dispozitivit ka aprovuar kompensimin e të ardhurave personale të ndaluara nga data e vendimit 01.nr.118-87652 lidhur me pezullimin parandalues të ankueses, ndërsa në pikën IV të dispozitivit është shfuqizuar Vendimi 01.nr.118-87652 i datës 11.04.2014 lidhur me pezullimin parandalues të ankueses.

Duke bazuar në konstatimet si me lart, rrjedhimisht së ankuesja është kthyer në vendin e saj të punës inspektore e ndërtimit, është shfuqizuar Vendimi për pezullimin parandalues të ankues dhe së ankueses i është bërë kompensimi i 50 % të të ardhurave personale të ndaluar nga pezullimi parandalues me datë 11.04.2014 deri në kthimin e saj në punë me datë 01.11.2021, të gjitha këto pretendime të parashtruara në ankesën A.nr.734/2021 të datës 12.08.2021, Kolegji i Këshillit vlerëson së qëllimi i kësaj ankese është përmbushur, andaj në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative me të cilën është përcaktuar se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë", konstaton së objekti i ankesës A.nr.734/është bërë i pamundur gjegjësisht i kotë, kështu që vendosi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.734/2021 të datës 12.08.2021.


Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit


Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda numër A.nr.734/2021

Avdyl BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

